



KOMISIONI EUROPIAN

Bruksel, 23.2.2022
C(2022) 1243 finale

VENDIMI I KOMISIONIT

datë 23.2.2022

Për ndryshimin e Vendimit të Komisionit C(2015) 5073, të datës 20 korrik 2015 Për miratimin e programi për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural i Republikës së Shqipërisë në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA II) për vitet 2014-2020

VENDIMI I KOMISIONIT

datë 23.2.2022

Për ndryshimin e Vendimit të Komisionit C(2015) 5073, të datës 20 korrik 2015 Për miratimin e programi për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural i Republikës së Shqipërisë në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA II) për vitet 2014-2020

KOMISIONI EUROPIAN

Bazuar në Traktatin për Funksonimin e Bashkimit Evropian,

Duke pasur parasysh Rregulloren (BE) Nr. 236/2014 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datë 11 Mars 2014, që përcakton rregullat dhe procedurat e përbashkëta për zbatimin e instrumenteve të Bashkimit për financimin e veprimit të jashtëm¹ dhe në veçanti Nenin 2(1) të saj,

Duke pasur parasysh Rregulloren (BE, Euratom) Nr. 2018/1046 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 18 korrikut 2018 për rregullat financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit, që ndryshojnë Rregulloret (BE) Nr. 1296/2013, (BE) Nr. 1301/2013, (BE) Nr. 1303/2013, (BE) Nr. 1304/2013, (BE) Nr. 1309/2013, (BE) Nr. 1316/2013, (BE) Nr. 223/2014, (BE) Nr. 283/2014, dhe Vendimin Nr. 541/2014/BE dhe që shfuqizon Rregulloren (BE, Euratom) Nr. 966/2012² dhe në veçanti nenin 110 të saj,

Ekzistojnë Këto Kushte Paraprake ku:

- (1) Me vendimin e tij C(2015) 5073 të 20 korrikut 2015, Komisioni miratoi Programin për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural të Republikës së Shqipërisë në kuadër të Instrumentit të Ndhmës së Para-Anëtarësimit (IPA II) për vitet 2014-2020 (referuar në vijim si "Programi IPARD II").
- (2) Më 25 nëntor 2021, Komiteti i Monitorimit për Programin IPARD II për Shqipërinë mori në shqyrtim dhe miratoi propozimin për ndryshimin e Programit IPARD II.
- (3) Më 2 dhjetor 2021 autoritetet kombëtare Shqiptare i paraqitën Komisionit një propozim për të ndryshuar Programin IPARD II, përfshirë planin financiar të rishikuar.
- (4) Ndryshimi i propozuar është i natyrës financiare, duke përfshirë ndryshimet e ndarjes financiare midis masave. Lidhet me përshtatjen e tabelave financiare në mënyrë që të merret parasysh rialokimi i buxhetit nga Masa 9 "Asistencë Teknike" në Masa 7 "Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i biznesit" dhe të shmanget kthimi i fondeve mbrapsht në vitin 2022.
- (5) Komisioni konsideron se ndryshimi i propozuar është i justifikuar siç duhet dhe rrjedhimisht, është e përshtatshme që Programi IPARD II të modifikohet në përputhje me rrethanat.
- (6) Prandaj, Vendimi Zbatues i Komisionit C(2015) 5073 i 20 korrikut 2015 duhet të ndryshohet në përputhje me rrethanat
- (7) Ndhima e parashikuar për Republikën e Shqipërisë është në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara nga masat kufizuese të miratuara në zbatim të nenit 215 TFUE3.

¹ OJ L 77, 15.3.2014, p. 95.

² OJ L 193, 30.7.2018, p. 1.

³ www.sanctionsmap.eu. Ju lutemi vini re se harta e sanksioneve është një mjet IT për identifikimin e regjimeve të sanksioneve. Burimi i sanksioneve buron nga aktet ligjore të botuara në Fletoren Zyrtare (FZ). Në rast mospërputhje midis akteve ligjore të publikuara dhe përditësimeve në faqen e internetit, është versioni i FZ-së ai që mbizotëron.

- (8) Masa e parashikuar në këtë vendim nuk përfshihet nën masat për të cilat kërkohet mendimi paraprak i Komitetit. Pasi të miratohet, ai do t'i komunikohet Parlamentit Evropian dhe Shteteve Anëtare nëpërmjet Komitetit IPA të ngritur sipas nenit 17 i Rregullores (BE) Nr 2021/15294 brenda 30 ditëve nga data e miratimit të saj,

VENDOSI:

Artikull i vetëm

Vendimi i Komisionit C(2015) 5073, datë 20 korrik 2015, për miratimin e Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA II), për vitet 2014-2020, ndryshohet, si më poshtë vijon:

1. Në nenin 2, paragrafi i dytë, tabela zëvendësohet me këtë përmbajtje:

“

Masa.	Kontributi i BE-së (EUR) 2014-2020
Investimet në pasuritë fizike të fermave bujqësore	32 600 370
Investimet në asetet fizike në lidhje me përpunimin dhe përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe të peshkimit	26 500 000
Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i biznesit.	11 765 000
Asistencë teknike	134 630
GJITHSEJ	71 000 000

”

2. Aneksi zëvendësohet me aneksin e këtij vendimi.

Bruksel, 23.2.2022

*Për Komisionin
Janusz WOJCIECHOWSKI
Anëtar i Komisionit*

⁴ OJ L 330, 20.9.2021, p.1.